



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

VENDIM

Nr. 410, datë 29.09.2021

PËR

**ZGJATJEN E AFATIT TË CAKTIMIT NË SKEMËN E DELEGIMIT TË
GJYQTARES ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 61, pika 2, shkronja “a”, nenin 86, shkronja “ë” dhe nenin 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, si dhe në Vendimin e tij nr. 401, datë 07.10.2020, pas shqyrtimit të nevojave të sistemit gjyqësor dhe në funksion të mbarëvajtjes së tij, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Zgjatjen e afatit të caktimit në skemën e delegimit të gjyqtares znj. {...} deri më datë 07.10.2022, afat që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.
2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 07.10.2021.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR